



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 57

Tiranë – E hënë, 12 prill 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 35/2021, datë 16.3.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”..... 5597
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 8.4.2021	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së furnizimit të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar “ <i>Keymen Ilaç Sanayi Ve Ticaret A.Ş.</i> ”..... 5598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1189, datë 24.12.2020	Për rregullat e kalimit të pronësisë, afatet, mënyrën e llogaritjes dhe të njoftimit të pagesës së truallit, zbritjet që përfitohen, si dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë, në zonat e stimuluar..... 5598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 190, datë 31.3.2021	Për përcaktimin e stemës dhe të flamurit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes..... 5604
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 191, datë 31.3.2021	Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s në Irak (NMI).. 5606
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 217, datë 7.4.2021	Për një shtesë fondi në programin “Mbështetje për partitë politike”, për financimin e fushatës zgjedhore të subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2021..... 5607
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 218, datë 7.4.2021	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë..... 5607
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 7.4.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 66, datë 29.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Vorë, Bashkia Vorë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”..... 5608

Urdhër i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 64, datë 30.3.2021	Për ngritjen dhe përbërjen e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.....	5610
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 64, datë 30.3.2021	Për delegimin e kompetencave.....	5611
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 17, datë 19.2.2021	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	5611
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 24, datë 5.3.2021	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	5611
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 31, datë 2.4.2021	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	5614
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 68, datë 12.3.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.....	5617
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 69, datë 12.3.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 461/1, seria P20, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 6.3.2020, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Backa 1” me kapacitet të instaluar 1600 kw, HEC “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kw, HEC “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kw, HEC “Backa B”, me kapacitet të instaluar 500 kw, HEC “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet total të instaluar 7320 kw.....	5618
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 70, datë 12.3.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Kurum International” sh.a., për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të shoqëria “Kurum International” sh.a., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Ulëz”, me kapacitet të instaluar 24 mw.....	5620
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 71, datë 12.3.2021	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin shkurt 2021.....	5621
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 72, datë 12.3.2021	Mbi miratimin e “Rregullave operacionale për furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, për sektorin e gazit natyror”.....	5622
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 79, datë 23.3.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s.....	5626



LIGJ
Nr. 35/2021

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 115/2017, “PËR KRIJIMIN
E AGJENCISË KOMBËTARE
TË DIASPORËS”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

Në ligjin nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8, shkronjat “b” dhe “ç” riformulohen si më poshtë:

“b) miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm administrativ, fushën e kompetencave dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave të brendshme, përshkrimin e punës së stafit administrativ e mbështetës të Agjencisë, si dhe miraton rregulloren për mënyrën e funksionimit dhe procedurat e vendimmarrjes së Këshillit Drejtues;

ç) shqyrton dhe propozon strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Agjencisë dhe ia dërgon për miratim dhe procedim të mëtejshëm ministrit përgjegjës për diasporën sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 4, të ligjit.

Neni 2

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1

Prokurime të veçanta të Agjencisë

Prokurimi i blerjeve të punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve, të cilat nevojiten të kryhen me qëllim zbatimin dhe realizimin e

programit vjetor të Agjencisë, përfshirë dhe pa u kufizuar në marrjen me qira të ambienteve dhe/ose pajisjeve dhe mallrave, lidhjen e kontratave të veçanta me bashkëpunëtorë të jashtëm ose figura të njohura shqiptare në diasporë, prokurimin e elementeve specifike të nevojshme në kuadër të zbatimit të detyrimeve të përcaktuara përmes marrëveshjeve ndërinstitucionale për organizimin e aktiviteteve, blerjen dhe/ose shpërndarjen e dhuratave të destinuara për aktivitete që zhvillohen brenda dhe jashtë vendit, por që nuk rregullohen nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik, kryhen sipas rregullave të përgjithshme, kritereve dhe procedurave specifike të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Në nenin 13, pika 1, pas togfjalëshit “Autoritetet shtetërore” shtohet togfjalëshi “dhe njësitë e qeverisjes vendore”.

Neni 4

Në nenin 16, pika 1, pas fjalëve “pika 5” shtohet numri i nenit “10/1”.

Neni 5

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë vendimin sipas përcaktimeve të nenit 2 të këtij ligji.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 16.3.2021.



AKT NORMATIV
Nr. 17, datë 8.4.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË
FURNIZIMIT TË NËNSHKRUAR
NDËRMJET MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR
RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË
SHËNDETIT PUBLIK DHE
DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR
“KEYMEN ILAÇ SANAYI VE TICARET
A.Ş.”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

1.

VENDOSI:

Neni 1

Miratimi i marrëveshjes ndryshuese

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së furnizimit të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar “*Keymen İlaç Sanayi ve Ticaret A.Ş.*”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1189, datë 24.12.2020

**PËR RREGULLAT E KALIMIT TË
PRONËSISË, AFATET, MËNYRËN E
LLOGARITJES DHE TË NJOFTIMIT TË
PAGESËS SË TRUALLIT, ZBRITJET QË
PËRFITOHEN, SI DHE MIRATIMIN E
MODELIT TË AKTIT TË KALIMIT TË
PRONËSISË, NË ZONAT
E STIMULUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 49, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) “Truall funksional”, i njësisë ndërtimore, është sipërfaqja e tokës e përcaktuar në planin e rlevimit, që i përket njësisë ndërtimore, ku përfshihet sipërfaqja nën njësi dhe ajo rreth saj;

b) “Truall i lirë”, sipërfaqja e tokës e përcaktuar në planin e rlevimit, brenda kufirit të zonës së stimuluar dhe jashtë kufirit të truallit funksional të njësisë ndërtimore, i tillë si: sheshe, pishina, sipërfaqe të gjelbëruara, rrugë apo sipërfaqe toke me destinacion dhe funksion të ngjashëm;

c) “Njësi ndërtimore”, objekti apo tërësia e objekteve, të përfunduara ose jo, si dhe të regjistruara ose jo në regjistrin e pasurive të paluajtshme, që pasqyrohen në planin e rlevimit, të hartuar sipas nenit 48, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;

ç) “Njësi individuale”, sipërfaqja e ndërtimit, brenda një njësie ndërtimore, që qëndron ose shfrytëzohet më vete nga ana funksionale, si p.sh.: apartament, njësi shërbimi etj.

**II. PROCEDURAT, DOKUMENTACIONI
DHE MODELI I AKTIT TË KALIMIT TË SË
DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN
NË ZONËN E STIMULUAR**



2. Procedura për miratimin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi truallin funksional apo truallin e lirë fillon:

a) me kërkesë të personit të stimuluar apo të subjektit të interesuar, në platformën unike qeveritare e-Albania, modeli i së cilës është sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi;

b) kryesisht, nga vetë drejtoria vendore e ASHK-së, në rastin kur subjekti i interesuar ka të regjistruar në regjistrin kadastral, në pronësi të tij njësinë ndërtimore apo individuale por nuk ka paraqitur kërkesë për kalimin e pronësisë së truallit.

3. Personat e stimuluar, që nuk kanë hyrë në marrëdhënie porosie, sipërmarrjeje, premtim-shitjeje, shitjeje, kalimi pronësie, dhurimi apo shkëmbimi për njësitë ndërtimore me të tretët, kanë të drejtë të kërkojnë kalimin e pronësisë për të gjithë truallin funksional dhe të lirë brenda zonës së stimuluar.

4. Personi i stimuluar, me kërkesën për kalimin e pronësisë së truallit, duhet të shlyejë tarifën e shërbimit në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

a) pavarësisht nëse nuk është në fuqi, vendimin e organeve kompetente për dhënien e titullit, sipas ligjit nr. 7665, datë 21.1.1993, “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, i shfuqizuar;

b) marrëveshjen e qirasë apo zhvillimit, lidhur ndërmjet personit të stimuluar dhe qiradhënësit, pavarësisht nëse është në fuqi ose jo, kur ka të tillë dhe subjekti e disponon atë;

c) dokumentacionin zyrtar për miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit, nëse i disponon;

ç) dokumentacionin e pronësisë për njësinë ndërtimore, nëse e disponon.

5. Subjekti i interesuar, me paraqitjen e kërkesës për kalimin e pronësisë së truallit, duhet të shlyejë tarifën e shërbimit në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe të dorëzojë pranë drejtorisë vendore të ASHK-së kontratën (origjinale ose kopje të njësuar) që provon veprimin juridik ndërmjet tij dhe personit të stimuluar, apo palëve të treta për porosinë, sipërmarrjen, premtim shitjen apo kalimin e së drejtës së pronësisë mbi njësinë, sipas përcaktimeve të nenit 49, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, në Republikën e Shqipërisë”.

6. Kur njësia ndërtimore përbëhet nga disa njësi individuale, të cilat posedohen nga dy ose më

shumë subjekte të interesuara, këto të fundit duhet të depozitojnë kërkesë individuale për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pjesën ideale takuese të truallit. Kalimi i pronësisë së truallit funksional në këtë rast, bëhet në bashkëpronësi dhe pjesët ideale të saj janë në të njëjtin raport me atë të sipërfaqeve të njësive individuale.

7. Përjashtimisht nga sa është parashikuar në pikën 6, të këtij vendimi, drejtoria vendore e ASHK-së mund të parcelizojë sipërfaqen e truallit funksional përreth njësive ndërtimore, fizikisht, ndërmjet subjekteve të interesuara që posedojnë njësi individuale. Ky rregull zbatohet nëse mbi 50 për qind e subjekteve shprehin vullnetin për parcelizimin, nëpërmjet një akti noterial, shoqëruar me planvendosjen përkatëse. Në këtë rast, ASHK-ja kryen procedurat e kalimit të pronësisë të kësaj sipërfaqeje të truallit funksional mbështetur në aktin noterial dhe në planvendosje. Në çdo rast, sipërfaqja e gjurmës së njësive ndërtimore kalohet në bashkëpronësi sipas pikës 6, të këtij vendimi.

8. Personit të stimuluar dhe/ose subjekteve të interesuara, përveç kalimit të pronësisë së truallit funksional, njëkohësisht iu kalohet bashkëpronësia e detyrueshme mbi truallin e lirë, proporcionalisht sipas raportit të sipërfaqes ndërtimore të secilit, përkundrejt shlyerjes së detyrimit përkatës, sipas kreut III, të këtij vendimi.

9. Nëse subjekti i interesuar nuk paraqet kërkesën për kalimin e pronësisë së truallit, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5, të këtij vendimi, brenda afatit 12-mujor nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, do të zbatohen parashikimet e nenit 51 të po të njëjtut ligji.

10. Kur njësia ndërtimore rezulton e paregjistruar në regjistrin kadastral, në favor të subjektit/eve të interesuar/a, këta të fundit e humbasin të drejtën për të përfituar kalimin e pronësisë së truallit dhe legalizimin e njësive ndërtimore, në bazë të pikës 1, të nenit 51, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, nëse nuk plotësojnë detyrimet e parashikuara në pikën 9, të këtij vendimi. Njësia ndërtimore legalizohet në favor të shtetit dhe regjistrohet si pronë shtetërore, së bashku me truallin funksional.

10.1. Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga regjistrimi i vendimit për legalizimin në favor të shtetit në



regjistrin kadastral, drejtoria vendore e ASHK-së njofton subjektin e interesuar/personin e stimuluar për dorëzimin vullnetar nëpërmjet një procesverbali dorëzimi, të njësisë ndërtimore. Procesverbali nënshkruhet nga përfaqësues të ASHK-së dhe subjekti i interesuar/personi i stimuluar. Dorëzimi konsiston në heqjen e sendeve të luajtshme të subjektit të interesuar nga njësi ndërtimore dhe marrjen e aksesit të ASHK-së në njësi. Dorëzimi vullnetar i njësisë ndërtimore kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.

10.2. Në rastin e mosdorëzimit vullnetar brenda afatit të përcaktuar, drejtoria vendore e ASHK-së nxjerr urdhrin për dorëzim të detyruar, i cili përbën titull ekzekutiv dhe ia njofton subjektit të interesuar/personit të stimuluar. Në qoftë se subjekti i interesuar apo, sipas rastit, personi i stimuluar, nuk ekzekutojnë urdhrin për dorëzim të detyruar, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi, drejtoria vendore e ASHK-së i kërkon gjykatës kompetente lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv dhe më tej kryen procedurat e nevojshme në funksion të ekzekutimit të detyrueshëm sipas titullit IV, të Kodit të Procedurës Civile.

11. Kur njësi ndërtimore ose njësi individuale është e regjistruar në pronësi të subjektit/eve të interesuar/a, drejtoria vendore e ASHK-së njofton detyrimin financiar për truallin funksional ose për pjesën ideale të tij, që i takon njësisë individuale, si dhe për pjesën ideale në truallin e lirë, në përputhje me rregullat e kreut III, të këtij vendimi. Në këto raste kalimi i pronësisë së truallit në favor të subjektit të interesuar është i detyruar, në mbështetje të pikës 3, të nenit 51, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

11.1. Procedura administrative nis kryesisht sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të këtij vendimi dhe ASHK-ja e fillon atë edhe gjatë periudhës 12-mujore nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, gjatë trajtimit të zonës së stimuluar sipas planveprimit të saj. Nëse subjekti i interesuar nuk shlyen vlerën e truallit brenda 1 (një) viti nga njoftimi i pagesës, atëherë ky njoftim kthehet në titull ekzekutiv dhe drejtoria vendore e njofton subjektin për këtë fakt. Nëse subjekti i interesuar sërish nuk e shlyen pagesën brenda 5

(pesë) ditëve nga njoftimi, atëherë drejtoria vendore e ASHK-së i kërkon gjykatës kompetente lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv dhe më tej kryen procedurat e nevojshme në funksion të ekzekutimit të detyrueshëm sipas titullit IV, të Kodit të Procedurës Civile.

12. Për njësitë ndërtimore që përbëhen nga disa njësi individuale, masat shtrënguese sipas nenit 51, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe pikave 10 dhe 11, të këtij vendimi, zbatohen vetëm mbi ato njësi individuale dhe pjesë takuese të truallit, të subjekteve që nuk respektojnë detyrimet e dispozitave të mësipërme. Për poseduesit e njërive të tjera, procedurat e kalimit të pronësisë sipas këtij vendimi vijnë normalisht.

13. Kur gjatë kryerjes së procedurave, sipas këtij vendimi, konstatohet se për të njëjtën njësi ndërtimore ose njësi individuale ka mbivendosje të aplikimeve nga dy ose më shumë subjekte të interesuara, kontratat e të cilave nuk kanë vijimësi kronologjike me njëra-tjetrën, procedurat vijnë në favor të subjektit që disponon kontratën më të hershme, në bazë të pikës 1, të nenit 53, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

13.1. Nëse një nga subjektet njofton drejtorinë vendore të ASHK-së se është në gjykim padia civile me palët e tjera, me objekt të drejtat mbi njësinë ndërtimore/individuale, atëherë drejtoria vendore e ASHK-së pezullon procedurën administrative për truallin dhe njësinë ndërtimore, ose nëse është rasti, vetëm për njësinë individuale dhe pjesën e saj ideale, që janë objekt i mosmarrëveshjes, deri në dorëzimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Drejtoria vendore e ASHK-së nuk është përgjegjëse për pasojat që vijnë nga vendimmarrja e saj, në rast se nuk është njoftuar zyrtarisht për zhvillimin e procesit gjyqësor nga pala e interesuar, shoqëruar me vërtetimin përkatës ose nga gjykata.

13.2. Për mosmarrëveshjet gjyqësore ndërmjet personit të stimuluar dhe subjektit të interesuar për njësitë ndërtimore/individuale, pezullimi shtrihet vetëm mbi ato njësi për të cilat ka akte noteriale ndërmjet palëve ndërgjyqëse dhe jo mbi njësitë e tjera. Për njësitë e tjera që janë objekt gjykimi por të papërfshira në aktin noterial, pezullimi i procedurës administrative në bazë të nenit 53, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, kryhet



vetëm nëse është urdhëruar shprehimisht nga gjykata në sigurimin e padisë. Në të kundërt drejtoria vendore e ASHK-së miraton vendimin e kalimit të pronësisë dhe nëse është rasti legalizimin e njësisë.

14. Për njësitë ndërtimore që janë të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pas regjistrimit (pasqyrimit në hartën kadastrale) të planit të rëlvimit nuk regjistrohet asnjë akt i mëtejshëm që ka për qëllim kalimin e pronësisë së njësisë së ndërtuar/individuale, deri në përfundimin e procedurave të kalimit të së drejtës së pronësisë mbi truallin, në mbështetje të nenit 50, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Në zbatim të kësaj pike, drejtoritë vendore të ASHK-së, menjëherë pas administrimit të planit të rëlvimit, regjistrojnë kufizimin në kartelat e pasurive të paluajtshme të njësive ndërtimore dhe njoftojnë subjektet e interesuara brenda 5 (pesë) ditëve nga regjistrimi i kufizimit.

15. Kur njësia ndërtimore ose pjesë e sipërfaqes së saj nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, zbatohen procedurat e legalizimit sipas parashikimeve të nenit 52, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore mbi rregullat e zbatimit të kritereve për legalizim.

16. ASHK-ja është e detyruar të miratojë vendimin për kalimin e pronësisë së truallit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e pasqyrimit në hartën kadastrale të planit të rëlvimit, që hartohet sipas nenit 48, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, vetëm në rast se personi i stimuluar ose subjekti i interesuar ka shlyer më parë detyrimin financiar për vlerën e truallit funksional dhe për pjesën ideale takuese në truallin e lirë, të llogaritur sipas kreut III, të këtij vendimi. Në të kundërt, miratimi i vendimit të kalimit të pronësisë kryhet vetëm pas shlyerjes së detyrimeve të mësipërme, brenda 5 (pesë) ditëve nga dorëzimi i dokumentacionit që vërteton pagesën.

Vendimi përbën titullin e pronësisë për truallin funksional/ pjesën ideale, dhe njëkohësisht për pjesën ideale në truallin e lirë. Në rastin e zbatimit të procedurave të legalizimit të njësive ndërtimore, sipas pikës 15, të këtij vendimi, atëherë nëpërmjet të njëjtit akt vendoset edhe për legalizimin e njësisë

ndërtimore dhe ai përbën titullin e pronësisë edhe për të. Modeli i vendimit është sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

17. Vendimi i kalimit të pronësisë bëhet i ekzekutueshëm dhe i regjistrueshëm në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasi të jetë plotësuar një nga kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë kaluar afati 30-ditor i paraqitjes së ankimit administrativ ndaj vendimit dhe ndaj tij nuk është paraqitur ndonjë ankim. Afati i ankimit llogaritet nga data e njoftimit të vendimit; ose

b) Të ketë përfunduar shqyrtimi i ankimit nga struktura e posaçme për ankimet në Drejtorinë e Përgjithshme dhe vendimi të jetë lënë në fuqi ose të jetë vendosur mospranimi i ankimit; ose

c) Në rastet kur struktura e posaçme për ankimet vendos për ndryshimin e përmbajtjes së vendimit të drejtorisë vendore ose shfuqizimin, apo anulimin, e pjesshëm të tij, ekzekutimi kryhet pasi drejtoria vendore të ketë miratuar vendimin e ri.

Për zbatimin e kësaj pike, drejtoria vendore është e detyruar të kërkojë informacion në rrugë elektronike pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme, përpara se të vijojë me procedurën e regjistrimit.

Përveç parashikimeve të mësipërme, në rastet e pikës 18, të këtij vendimi, regjistrimi i kalimit të pronësisë së truallit kryhet pasi të jetë miratuar kompensimi financiar i pronarëve joposedues.

18. Nëse trualli funksional apo i lirë, figuron në pronësi të të tretëve, të cilët nuk kanë marrëveshje me personin e stimuluar, apo subjektet e interesuara, për rregullimin e raporteve të pronësisë, ASHK-ja pas miratimit të vendimit të kalimit të pronësisë, zbaton procedurat e kompensimit të pronarëve joposedues, sipas nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. I njëjti rregullim vlen edhe nëse të tretët kanë një titull pronësie të paregjistruar më parë, me kushtin që ky i fundit të jetë depozituar pranë ASHK-së.

Në këto raste, kalimi i pronësisë së truallit, sipas vendimit të drejtorisë vendore të ASHK-së, hyn në fuqi pas miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për kompensimin e pronarëve joposedues. Kur vendimi i drejtorisë vendore të ASHK-së përmban edhe dispozitat për legalizimin e njësive ndërtimore, atëherë kjo e fundit



registrohet pa marrëdhënie me truallin deri në miratimin vendimit të Këshillit të Ministrave për kompensimin e pronarëve joposedues.

III. MËNYRA E LLOGARITJES SË VLERËS SË TRUALLIT, AFATET DHE PROCEDURA E NJOFTIMIT PËR PAGESËN

19. Njoftimi drejtuar personit të stimuluar dhe/ose subjektit të interesuar, për detyrimin financiar të kalimit të pronësisë përfshin vlerën e truallit funksional dhe vlerën e pjesës ideale takuese në truallin e lirë.

20. Llogaritja e vlerës së truallit funksional kryhet nga ASHK-ja në bazë të çmimit për pasurinë e llojit “truall”, të përcaktuar në hartën e vlerës së pronës, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

21. Për truallin e lirë brenda zonës së stimuluar, çmimi i shitjes është i barabartë me $\frac{1}{2}$ e çmimit për pasurinë e llojit “truall”, të përcaktuar në hartën e vlerës së pronës, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nëse kryejnë pagesën brenda 4 muajve nga dita e njoftimit. Përfshihet, kur truall i lirë rezulton në pronësi të të tretëve (i regjistruar ose jo në regjistrin kadastral) dhe për të ASHK-ja duhet të kryejë procedurat e kompensimit të pronarëve joposedues, çmimi është i plotë, sipas hartës së vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

22. Drejtoria vendore e ASHK-së i njofton me shkrim personit të stimuluar/subjektit të interesuar faturën financiare të truallit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dërgimi i planit të rëlvimit për pasqyrim në hartën kadastrale.

Në mungesë të adresës postare, njoftimi bëhet me shpallje publike për 30 (tridhjetë) ditë në ambientet e drejtorisë vendore të ASHK-së, në faqen e saj zyrtare on-line, si dhe në një vend të dukshëm në njësinë administrative përkatëse. Në këtë rast, llogaritja e afateve të pagesës sipas pikave 20 dhe 21, të këtij vendimi, nis pas ditës së fundit të shpalljes.

23. Kryerja e pagesës së vlerës së truallit të njësisë ndërtimore brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vlerës së detyrimit financiar, sjell reduktim të saj në masën 10%. Nëse shlyerja bëhet pas këtij afati, por brenda tre muajve, atëherë personi i stimuluar/subjekti i interesuar nuk e përfiton zbritjen e vlerës, por as nuk i llogaritet kamatëvonesë.

24. Në rast mospagimi të vlerës së detyrimit brenda afatit tremujor të përcaktuar në pikën 23, të këtij vendimi, për çdo muaj vonesë llogaritet kamatë në masën 10 për qind të vlerës së detyrimit. Shlyerja e detyrimit të plotë është parakusht për miratimin e vendimit të kalimit të pronësisë së truallit dhe, nëse është rasti, legalizimit të njësisë ndërtimore. Në rastet e njësisë ndërtimore që janë të regjistruara në pronësi të subjektit të interesuar, njoftimi i pagesës së truallit kthehet në titull ekzekutiv, nëse nuk shlyhet brenda 1 (një) viti, sipas procedurës së parashikuar në pikat 11 dhe 11.1, të këtij vendimi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

25. Kërkesat për kalimin e pronësisë së truallit në zonat e stimuluar, të administruara përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, për të cilat nuk ka përfunduar procedura administrative, i nënshtrohen rregullave të këtij vendimi.

26. Kërkesa e subjekti të interesuar, dorëzuar pranë ASHK-së nga data 7 maj 2020 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, njësohet me atë të paraqitur sipas këtij vendimi. Subjekti që ka bërë kërkesë sipas kësaj pike duhet të shlyejë tarifen e shërbimit nëse nuk e ka shlyer atë më parë.

27. Për subjektet e interesuara apo personat e stimuluar, të cilëve u është kaluar pronësia mbi truallin funksional, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ASHK-ja vijon me kalimin në bashkëpronësi të detyrueshme të truallit të lirë, sipas procedurës në vijim:

a) Verifikon në regjistrin kadastral gjendjen juridike të njësisë ndërtimore dhe përcakton sipërfaqen e truallit të lirë për kalim pronësie.

b) Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga verifikimi, harton listën emërore me subjektet përfituese, së bashku me sipërfaqet takuese sipas raporteve/pjesëve takuese. Përfshihet, nëse subjektet përfituese paraqesin marrëveshje noteriale për kalimin e të drejtave të truallit të lirë, ASHK-ja kryen kalimin sipas përcaktimeve në marrëveshje.

c) Informacioni i mësipërm i komunikohet subjekteve përfituese në të njëjtën mënyrë si në pikën 22, të këtij vendimi.

28. Kur drejtoria vendore e ASHK-së njoftohet nga pala e interesuar apo nga gjykata se është ngritur padi, me objekt njohjen e pronësisë ose



bashkëpronësisë mbi truallin, pavlefshmërinë e titullit të pronësisë mbi të, apo për çdo mosmarrëveshje të të tretëve për raportet e pronësisë në truall, të cilët nuk kanë pretendime mbi njësitë ndërtimore, procedura administrative sipas kreut V, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe dispozitave të këtij vendimi, nuk pezullohet. Në këto raste, për titujt e pronësisë të të tretëve, të regjistruar më parë ose jo, kompensimi financiar, sipas nenit 54, të ligjit të mësipërm, miratohet pa përcaktuar subjektin përfitues. Vlera e kompensimit financiar vendoset në një llogari bankare të posaçme dhe vihet në dispozicion të subjekteve që do të rezultojnë përfitues, pasi të jetë gjykuar padia, me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kur në bazë të vendimit gjyqësor, titulli i pronësisë së pronarit joposëdues anulohet ose konstatohet i pavlefshëm dhe pronësia nuk i njihet asnjë subjekti tjetër privat, shuma e miratuar e kompensimit rikthehet në fondin financiar të kompensimit, të krijuar sipas ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronës”.

29. Ekzekutimi i vendimeve të Këshillit të Ministrave, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, që kanë përcaktuar masën dhe vlerën e kompensimit të subjekteve, të cilat gjenden në kushtet e pikës 28, të këtij vendimi, për efekt të dhënies së shumës subjektivit përfitues, pezullohet deri në përfundim të gjykimit të padisë, pa penguar kalimin e pronësisë së truallit sipas kreut V, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe regjistrimin e shpronësimit dhe të aktit të kalimit të pronësisë të miratuar sipas këtij vendimi.

30. Vendimi gjyqësor për sigurimin e padisë përbën shkak për pezullimin e procedurës administrative të kompensimit dhe kalimit të pronësisë së truallit sipas kreut V, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, vetëm nëse gjykata ka urdhëruar shprehimisht pezullimin e saj. Nëse vendimi gjyqësor disponon vetëm për mosregjistrimin e veprimeve të kalimit të pronësisë të palëve ndërgjyqëse apo të të tretëve mbi pasurinë, atëherë kompensimi i pronarëve, si procedurë shpronësimi, së bashku me kalimin e pronësisë, nuk pezullohet. Drejtoria vendore e ASHK-së është e detyruar të kryejë regjistrimin e

akteve të kompensimit dhe të kalimit të pronësisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

31. Gjatë gjykimit të padive të kthimit të sendit truall ose të atyre me objekt pavlefshmërinë apo anulimin e marrëveshjes së qirasë dhe zhvillimit dhe/ose të akteve të miratimit të “zonës së stimuluar”/titullit “person i stimuluar” apo të lejes së ndërtimit, procedura administrative pezullohet vetëm në rast se është vendosur sigurimi i padisë, sipas kushtit të pikës 30, të këtij vendimi. I njëjti rregull zbatohet edhe për paditë me objekt detyrimin e drejtorive vendore të ASHK-së për të rrëzuar kërkesën e personit të stimuluar për kalimin e pronësisë.

32. Modelet e procesverbalit për dorëzim vullnetar dhe të urdhrat për dorëzim të detyruar, sipas pikave 10 deri në 10.2, të këtij vendimi, miratohen me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së.

33. Pas kryerjes së procedurave administrative, sipas këtij vendimi, drejtoria vendore e ASHK-së njofton Agjencinë Kombëtare të Turizmit për përfundimin e procedurave të kalimit të pronësisë në zonën e stimuluar.

34. Për ato pasuri që kalohen në pronësi dhe legalizohen në favor të personit të stimuluar, pas përfundimit të procedurave sipas këtij vendimi, njëkohësisht me regjistrimin e akteve të kalimit të pronësisë dhe legalizimit, regjistrohet edhe hipoteka ligjore, deri në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të personit të stimuluar, që burojnë nga marrëveshjet e qirasë dhe të zhvillimit të lidhura mes tyre dhe autoriteteve kompetente sipas ligjit të kohës.

Hipoteka ligjore garanton vetëm detyrimet për periudhën, gjatë së cilës kanë qenë në fuqi marrëveshjet e mësipërme dhe në asnjë rast nuk regjistrohet mbi pasuritë që legalizohen dhe kalohen në pronësi të subjekteve të interesuara ose në pjesët takuese të tyre në truallin e lirë.

35. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 5.5.2010, “Për mënyrën dhe llogaritjen e afateve të pagimit të çmimit të truallit për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin shtetëror, në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, dhe nr. 645, datë 22.7.2015, “Për përcaktimin e afateve dhe të procedurave të kalimit të bashkëpronësisë së detyrueshme mbi truallin e lirë, në zonat me përparësi turizmin”, shfuqizohen.

36. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 190, datë 31.3.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E STEMËS DHE TË
FLAMURIT TË AGJENCISË SË
INTELIGJENCËS DHE SIGURISË
SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

Aneksi nr. 1.

Stema e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes



Në një rreth me sfond blu dhe të kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet në ngjyrë të artë “AGJENCIA E INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES” në pjesën e sipërme në brendësi të rrethit dhe “REPUBLIKA E SHQIPËRISË” në pjesën e poshtme në brendësi të rrethit. Në sfondin blu, me ngjyrë blu më të çelur paraqitet globi, i cili simbolizon

VENDOSI:

1. Miratimin e stemës dhe të flamurit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Stema dhe flamuri dekorativ i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për nga qëllimi i përdorimit, i përkasin vetëm strukturës së kësaj agjencie. Ndalohet shumëfishimi, imitimi dhe përdorimi i tyre nga institucionet apo subjektet e tjera, që, sipas ligjit, përdorin uniformë.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në përmbushje të misionit të saj. Në qendër të stemës është vendosur shqiponja dykrenore me ngjyrë të artë dhe mbi të përkrenarja e heroit kombëtar, Skënderbeut.

Në anën e majtë të stemës, midis shqiponjës dhe mbishkrimit, është i vendosur i qendërzuar pishtari, i cili simbolizon diturinë dhe inteligjencën.

Në anën e djathtë të stemës, midis/ndërmjet shqiponjës dhe mbishkrimit, është i vendosur i qendërzuar çelësi, i cili simbolizon informacionin dhe sekretin.

Midis kthetrave të shqiponjës dhe mbishkrimit “REPUBLIKA E SHQIPËRISË” janë vendosur dy degë lisi të gërshetuara, të cilat simbolizojnë qëndrueshmërinë, madhështinë dhe jetëgjatësinë.

Ngjyra e artë, e përdorur në elementet e stemës përfaqëson simbolikën tradicionale të kësaj ngjyre:

- Fuqinë dhe superioritetin;
- Të mirën dhe përsosmërinë;
- Diturinë dhe inteligjencën.

Ngjyra blu, e përdorur në sfond të stemës simbolizon thellësinë e mendimit, si dhe besueshmërinë, trimërinë, stabilitetin, nderin e fuqinë.

Kodi i ngjyrave:

Blu: #182851;

E verdhë: #FCD212;

Gri: #9B9A9A;

Portokalli: #C05927;

Jeshile: #2E4921;

E verdhë e degës: #C1B130;

E kuqe: #AA1F24.

Aneksi nr. 2

Flamuri dekorativ i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes



Flamuri është prej pëlhure tekstili me ngjyrë blu të errët dhe ka të stampuar në qendër stemën e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes. Flamuri ka përmasat 107 x 150 cm dhe rrethohet nga një kordon dekorativ i artë. Shtiza është prej metali. Qëndrueshmëria e ngjyrës së copës së tekstit,



kordonit rrethues dhe elementeve dekorative janë të nivelit të lartë. Shtiza metalike të jetë e mbrojtur nga korrozioni dhe me mbrojtje dekorative ngjyrë ari.

Flamuri vendoset në një shtizë metalike me gjatësi 2.5 m (me gjithë shqyt) dhe diametër 3 cm. Shtiza vendoset në një bazament metalik të rrumbullakët me diametër 30 cm dhe lartësi deri në 5 cm. Shtiza e flamurit në krye mbyllet me një shqyt trekëndësh me gjatësi 15 cm. Montimi i flamurit në shtizë bëhet në dy fiksues me lidhëse në formë kordonit, të cilat përfundojnë me xhufkë.

VENDIM

Nr. 191, datë 31.3.2021

PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E NATO-s NË IRAK (NMI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të 1 (një) ushtaraku të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në operacionin e NATO-s në Irak (NMI), në Bagdad, Irak.

2. Misioni i ushtarakut është këshillimi për stafin e Universitetit të Mbrojtjes së Irakut, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e moduleve të programeve të arsimimit dhe detajimin e organizimit të kurseve, duke përfshirë strukturën dhe procedurat, si dhe këshillimi për praktikën më të mira për stafin kryesor të Universitetit të Mbrojtjes.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 5 (pesë) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të përfaqësuesit të parë në mision. Periudha e qëndrimit në mision do të jetë me sistem rotacioni në çdo 1 (një) vit, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me

kontingjentin e radhës (marrjen dhe dorëzimin e detyrës, vonesa të transportit strategjik).

4. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pages mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

dh) energji elektrike, ujë dhe ujë i pijshëm;

e) transport;

ë) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së misionit.

5. Transporti i personelit, që do të shërbejë në Irak, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën, për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanderia, transporti i personelit të shkëputur nga misioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, ku pala tjetër merr përsipër të përballojë këto shpenzime.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



VENDIM

Nr. 217, datë 7.4.2021

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
PROGRAMIN “MBËSHTETJE PËR
PARTITË POLITIKE”, PËR
FINANCIMIN E FUSHATËS
ZGJEDHORE TË SUBJEKTEVE
PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR
KUVENDIN E SHQIPËRISË,
TË VITIT 2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për financimin e fushatës zgjedhore për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, në programin “Mbështetje për partitë politike”, shtohet fondi prej 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekësh, i cili iu shpërndahet subjekteve zgjedhore, pjesëmarrëse në këto zgjedhje, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

2. Efekti financiar i parashikuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM

Nr. 218, datë 7.4.2021

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË
BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të bëhet rishpërndarje e fondeve ndërmjet programeve buxhetore, si më poshtë vijon:

a) në programin buxhetor “Menaxhimi i të ardhurave tatimore” 01140 shtohet fondi prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh në shpenzime kapitale për projektin “Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit”;

b) në programin buxhetor “Arsimi i mesëm profesional” 09240 të pakësohet fondi prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, në shpenzime kapitale.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



VENDIM
Nr. 223, datë 7.4.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 66, DATË 29.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE VORË, BASHKIA VORË, DHE ÇAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “iii” e “iv”, dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Harta dhe koordinatat bashkëlidhur vendimit nr. 66, datë 29.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, përkatësisht, me hartën dhe koordinatat sipas anekseve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Vorë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe





ANEKS 1

KOORDINATAT E ZONËS QË PËRFSHIHET NË
PLANIN PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR

Nr. i pikës	Koordinata X	Koordinata Y
1	387491.0677	4583600.059
2	387427.2291	4583533.672
3	387362.4874	4583461.196
4	387360.6915	4583457.465
5	387361.1482	4583453.351
6	387368.4761	4583435.532
7	387378.6142	4583438.754
8	387392.4698	4583435.071
9	387418.2793	4583406.746
10	387408.9692	4583398.256
11	387429.5868	4583375.644
12	387438.8928	4583384.13
13	387448.7264	4583373.35
14	387450.0926	4583366.138
15	387455.2309	4583364.177
16	387462.5832	4583370.655
17	387471.7409	4583367.952
18	387535.9989	4583303.783
19	387542.8564	4583296.704
20	387598.1027	4583237.419
21	387603.332	4583223.188
22	387606.3609	4583204.135
23	387607.4295	4583193.116
24	387606.8848	4583179.503
25	387602.6855	4583166.542
26	387598.9162	4583156.949
27	387598.4234	4583141.494
28	387607.1388	4583128.848
29	387622.2013	4583116.79
30	387630.1944	4583110.522
31	387654.349	4583088.783
32	387675.1325	4583067.669
33	387688.4149	4583051.978
34	387694.8301	4583042.783
35	387849.0995	4583198.441

ANEKS 2

KOORDINATAT E NËNZONAVE QË NUK
PREKEN NGA ZHVILLIMI I DETYRUAR

NËNZONA 1

Nr. i pikës	Koordinata X	Koordinata Y
B1	387822.9188	4583187.095
B2	387763.2491	4583126.772
B3	387708.2817	4583183.338
B4	387696.6678	4583195.419
B5	387712.5715	4583209.585
B6	387726.1399	4583194.351
B7	387774.9719	4583239.676

NËNZONA 2

B8	387601.904	4583447.773
B9	387562.7782	4583413.135
B10	387508.6172	4583472.557
B11	387546.2784	4583506.525

NËNZONA 3

B12	387532.1992	4583506.081
B13	387502.4171	4583479.36
B14	387475.0333	4583568.813
B15	387447.5666	4583539.899

NËNZONA 4

B16	387407.7935	4583498.829
B17	387373.3638	4583460.318
B18	387374.0302	4583453.26
B19	387382.3921	4583449.739
B19/1	387389.0586	4583449.601
B19/2	387425.1226	4583483.336

NËNZONA 5

B20	387490.5812	4583391.019
B21	387476.7872	4583377.767
B22	387546.8082	4583332.786
B23	387533.4891	4583321.112

NËNZONA 6

B24	387557.2782	4583327.73
B25	387541.7521	4583312.892
B26	387632.3212	4583251.446
B27	387614.0963	4583236.187

NËNZONA 7

B28	387636.9155	4583240.691
B29	387624.7525	4583230.486
B30	387613.0752	4583220.058
B31	387614.1822	4583212.685
B32	387615.6768	4583178.111
B33	387607.2427	4583153.803
B34	387606.9767	4583143.955



B35	387612.6072	4583135.871
B36	387620.0539	4583129.91
B37	387627.5005	4583123.948
B38	387636.1481	4583117.137
B39	387652.0523	4583102.824
B40	387669.626	4583120.005
B41	387671.2491	4583118.472
B42	387673.3213	4583118.992
B43	387691.635	4583098.399
B44	387673.9303	4583082.179
B45	387681.8412	4583073.517
B46	387693.0527	4583060.615
B47	387695.171	4583058.732
B48	387699.505	4583062.565
B49	387755.0839	4583118.498

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 64, datë 30.3.2021

PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT SEKTORIAL TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, të ndryshuar, të vendimit nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre”, ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe ministri përgjegjës për arsimin

URDHËROJNË:

1. Ngritjen e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

2. Komiteti Sektorial TIK, organizohet në formën e grupit teknik dhe ka në përbërje 10 (dhjetë) anëtarë, si më poshtë:

a) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;

b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional;

c) një përfaqësues nga ministria/institucioni përgjegjës për sektorin e TIK-ut;

ç) një përfaqësues nga shoqatat e punëdhënësve të sektorit të TIK-ut, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;

d) një përfaqësues nga shoqatat e punëmarrësve që mbulojnë sektorin TIK, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;

dh) një përfaqësues nga institucionet ofruese të arsimit dhe të formimit profesional (AFP) të sektorit TIK, me numrin më të madh të nxënësve/kursantëve në sektorin përkatës;

e) një përfaqësues të biznesit me praktika të pasura në zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin TIK;

ë) tre ekspertë të pavarur, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

3. Kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të komitetit dhe, si rregull, duhet të jetë anëtar me më shumë eksperiencë në çështjet e TIK-ut dhe në zhvillimin e zbatimit të KSHK-së.

4. Ngarkohen ministratë përgjegjëse respektive për caktimin e anëtarëve të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “dh”, të pikës 2, të këtij urdhri, në bazë të kriterëve të parashikuara në vendimin nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe përcjelljen e tyre Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), jo më vonë se 1 (një) muaj nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

5. Ngarkohet AKAFPK-ja për përzgjedhjen e anëtarëve të parashikuar në shkronjat “ç”, “d”, “e” dhe “ë”, të pikës 2 të këtij urdhri, si dhe titullari i saj për ngritjen e sekretariatit teknik, brenda 1 (një) muaj nga hyrja e tij në fuqi.

6. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, ministria përgjegjëse për arsimin, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Komiteti Sektorial i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Anila Denaj

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË

Evis Kushi



URDHËR
Nr. 64, datë 30.3.2021

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, z. Oltjon Muzaka, lidhur me trajtimin e praktikës me nr. 538 prot., datë 19.3.2021, mbi miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar.

2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm z. Oltjon Muzaka.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Anila Denaj

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**
Nr. 17, datë 19.2.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pikat “a”, “c”, dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018 “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i

ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 4, datë 19.2.2021, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. **Kartelë Model 2**, nr. 369, 23898, në ngarkim të **I.A.**, me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.

2. **Kartelë Model 2**, nr. 7225, në ngarkim të **H.K.**, me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

3. **Evidenca agenturalo-operative nr. 300**. Evidenca i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

KRYETAR I KOMISIONIT TË
DEKLASIFIKIMIT
DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**
Nr. 24, datë 5.3.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pikat “a”, “c”, dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3. 5.2018 të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 5, datë 5.3.2021, si më poshtë:

I. Deklasifikoj plotësisht informacionet e mëposhtme:



1. **Dosje përpunimi nr. 280**, në ngarkim të **Sh.B.**, me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

2. **Dosje përpunimi nr. 348**, në ngarkim të **D.A.**, me 104 (njëqind e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1950–1990. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

3. **Regjistër i dosjeve të objektit, drejtimit, kërkimit, fashikujt e të huajve etj.** nr. 5 prot., datë 10.6.1975, me 100 (njëqind) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”. Dokumenti daton në vitet 1967–1990. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

4. **Libër i dorëzimit të informatave, shënime operative etj.**, nr. 34, nr. 8 prot., datë 10.6.1975, me 90 (nëntëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”. Dokumenti daton në vitet 1973–1987. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

5. **Indeksi alfabetik i informatave** nr. 27 prot., datë 20.4.1987, model 5, me 146 (njëqind e dyzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”. Dokumenti daton në vitet 1987–1991. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

6. **Libri i dorëzimit të dokumenteve** nr. 29 prot., datë 20.4.1987, me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”. Dokumenti daton në vitet 1987–1991. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

7. **Regjistër alfabetik këshillime demaskime** nr. 28 prot., datë 20.4.1987, model 7, me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”. Dokumenti daton në vitet 1987–1989. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

8. **Regjistër i dosjeve dhe fashikujve** nr. 30 prot., datë 20.4.1987, me 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”. Dokumenti daton në vitet 1974–1991. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

9. **Dosje personale dhe pune nr. 534**, në ngarkim të **Xh.Sh.**, me 30 (tridhjetë) fletë në total.

Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1984–1989. Dosja i përket fondit 141 ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

10. **Dosje personale dhe pune nr. 1629**, në ngarkim të **H.M.**, me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit 141 ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

11. **Dosje personale dhe pune nr. 1409**, në ngarkim të **F.A.**, me 46 (dyzet e gjashtë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit 141 ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

12. **Dosje personale dhe pune nr. 1421**, në ngarkim të **Y.H.**, me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit 141 ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

13. **Dosje personale dhe pune nr. 1349**, në ngarkim të **F.B.**, me 61 (gjashtëdhjetë e një) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit 141 ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

14. **Dosje personale nr. 1926**, në ngarkim të **A.Sh.**, me 14 (katërmbëdhjetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitin 1989. Dosja i përket Fondit 141 ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

15. **Kartelë model 2** nr. 1733, në ngarkim të **Y.H.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

16. **Kartelë model 2** nr. 117, në ngarkim të **S.D.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

17. **Kartelë model 2** nr. 1688, në ngarkim të **N.G.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

18. **Kartelë model 2**, nr. 737, në ngarkim të **S.Sh.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

19. **Kartelë model 2** nr. 412, në ngarkim të **K.P.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.



20. **Kartelë model 2** nr. 171, në ngarkim të **Xh.G.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

21. **Kartelë model 2** nr. 165, në ngarkim të **Q.G.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

22. **Kartelë model 2** nr. 124, në ngarkim të **M.D.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

23. **Kartelë model 2** nr. 118, në ngarkim të **M.D.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

24. **Kartelë model 2** nr. 125, në ngarkim të **P.D.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

25. **Kartelë model 2** nr. 25236, në ngarkim të **A.S.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

26. **Kartelë model 2** nr. 1626, në ngarkim të **F.S.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

27. **Kartelë model 2** nr. 1893, në ngarkim të **A.Sh.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

28. **Kartelë model 2** nr. 163, në ngarkim të **N.G.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

29. **Kartelë model 2** nr. 167, në ngarkim të **D.G.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

30. **Kartelë model 2** nr. 216, në ngarkim të **J.H.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

31. **Vendim për heqjen nga përpunimi të dosjes 622**, datë 15.7.1989, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

32. **Vendim për heqjen nga kontrolli operativ 2/B të dosjes 522**, datë 22.11.1989, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

33. **Vendim për heqjen nga kontrolli operativ 2/B të dosjes 355**, datë 5.11.1989, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

34. **Vendim për heqjen nga kontrolli operativ 2/B të dosjes 282**, datë 20.12.1990, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

35. **Vendim për heqjen nga kontrolli operativ 2/B të dosjes 163**, datë 20.12.1990, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

36. **Procesverbal i Komisionit të ekspertizës** së ruajtjes së dokumenteve për asgjësimin e 7 dokumenteve, i datës 16.1.1991, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

37. **Procesverbal i Komisionit të ekspertizës** së ruajtjes së dokumenteve për asgjësimin e 2 dokumenteve, i datës 16.1.1991, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

38. **Listë veçimi i Komisionit të ekspertizës** për asgjësimin e dosjeve të përpunimit nr. 2, datë 3.1991, me (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Skrapar.

39. **Kartelë model 2 nr. 4268**, në ngarkim të **V.Zh.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë.

40. **Dosje personale** dhe pune në ngarkim të **F.F.**, përkatësisht me 101 (njëqind e një) fletë dhe 44 (dyzet e katër) fletë, si dhe fashikull i materialeve të përgatitjes me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1956–1992. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria II.

41. **Dosje përpunimi nr. 213**, në ngarkim të **A.H.(K.)**, me 108 (njëqind e tetë) fletë dhe 14



(katërbëdhjetë) fletë në zarf, si dhe fashikull personal për të dënuar me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1943–1991. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

42. **Dosje nr. 2617/121**, me materiale për **G.H.**, me 2 volume, me 34 (tridhjetë e katër) fletë dhe 49 (dyzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1943–1982. Dosja i përket ish-Fondit Operativ.

43. **Dosje formulare nr. 269**, në ngarkim të **M.D.**, me 204 (dyqind e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1958–1985. Dosja i përket ish-Fondit Operativ.

44. **Dosje përpunimi nr. 1227**, në ngarkim të **R.V.**, me 13 (trembëdhjetë) fletë dhe 1 (një) fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1978–1990. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të brendshme Krujë.

45. **Kartelë model 2 nr. 4268** në ngarkim të **V.Zh.**, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të kartelës është “Sekret A.R.P”. Kartela i përket Fondit ish-Dega IV.

46. **Libri i evidencës së punëtorit operativ në zonë nr. 1**, me 225 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Libri daton deri në vitin 1990. Libri i përket Fondit Ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

47. **Evidenca agjenturore – operative e punëtorit operativ nr. 191**, me 250 (dyqind e pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Libri daton deri në vitin 1983. Libri i përket Fondit Ish-Drejtoria II.

48. **Dosje personale dhe pune nr. 4468 dhe 4468/1**, në ngarkim të **A.G.**, me përkatësisht me 18 (tetëmbëdhjetë) dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Korçë.

49. **Dosje personale dhe pune nr. 8051**, në ngarkim të **E.Z.**, me përkatësisht me 18 (tetëmbëdhjetë) dhe 24 (njëzet e katër) fletë. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Korçë.

50. **Dosje personale dhe pune 381 dhe 381/1**, në ngarkim të **F.B.**, me përkatësisht me 53 (pesëdhjetë e tre) dhe 134 (njëqind e tridhjetë e

katër) fletë. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Korçë.

51. **Kartelë model 2 nr. 380**, në ngarkim të **R.B.**, me 1 (një) fletë. Kartela i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Korçë.

52. **Kartelë model 2 nr. 8**, në ngarkim të **A.C.**, me 1 (një) fletë. Kartela i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Korçë.

53. **Kartelë model 2 nr. 4546**, në ngarkim të **A.P.**, me 1 (një) fletë. Kartela i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Korçë.

54. **Kartelë model 2 nr. 6432**, në ngarkim të **S.C.**, me 1 (një) fletë. Kartela i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Korçë.

55. **Kartelë model 2 nr. 5524**, në ngarkim të **Sh.M.**, me 1 (një) fletë. Kartela i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Korçë.

II. Deklasifikimin pjesërisht të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” që gjendet në dokumentin si më poshtë:

1. Fondi Ish-Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, fletë regjistri i agjenturës model 2, konkretisht rreshti me numër rendor 4268, në ngarkim të **V.Zh.**, me 1 (një) fletë. Dokumenti daton në vitin 1988. Niveli i klasifikimit është “Sekret”.

KRYETAR I KOMISIONIT TË
DEKLASIFIKIMIT
DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH Nr. 31, datë 2.4.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pikat “a”, “c”, dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018 “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018, të kryetarit



të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 6, datë 2.4.2021, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. **Dosje përpunimi nr. 3342**, në ngarkim të **Dh.B.**, me 239 (dyqind e tridhjetë e nëntë) fletë dhe 7 (shtatë) fletë në zarf, si dhe fashikull personal për të dënuar me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Vlorë.

2. **Dosje përpunimi nr. 4613**, fashikull personal për të dënuar, si dhe fashikull me pseudonimin “Bloza”, në ngarkim të **Z.B.**, me 741 (shtatëqind e dyzet e një) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Durrës.

3. **Dosje formulare nr. 534**, në ngarkim të **D.K.**, me 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

4. **Dosje formulare nr. 549**, në ngarkim të **M.O.**, me 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

5. **Dosje O.R.V nr. 394 miniera Mborje–Drenovë**, me 2 fashikuj me 275 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Korçë.

6. **Dosje nr. 2805** me materiale që bëjnë fjalë për **O.N.**, me 53 (pesëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

7. **Dosje formulare nr. 557**, në ngarkim të **T.N.**, me 102 (njëqind e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-të Huajt.

8. **Fashikull nr. 4177**, në ngarkim të **H.B.**, me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-të Huajt.

9. **Fashikull nr. 4442 dhe dosje përpunimi nr. 5567**, në ngarkim të **P.P.**, përkatësisht me 11

(njëmbëdhjetë) fletë dhe 44 (dyzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-të Huajt.

10. **Dosje formulare nr. 2680/7**, në ngarkim të **M.T.**, me 20 (njëzet) fletë dhe një zarf me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-të Arratisur.

11. **Dosje personale nr. 40**, në ngarkim të **G.T.**, me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

12. **Dosje kërkimi nr. 131**, në ngarkim të **Z.Ç.**, me 10 (dhjetë) fletë dhe një zarf me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-të Arratisur.

13. **Dosje përpunimi nr. 4411 dhe fashikull personal për të dënuar**, në ngarkim të **N.Sh.**, përkatësisht me 173 (njëqind e shtatëdhjetë e tre) fletë dhe 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Vlorë.

14. **Dosje përpunimi nr. 12451**, në ngarkim të **P.K.**, me 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

15. **Procesverbal i datës 25.6.1990**, për heqjen e përpunimeve 2A,2B,PP, të dosjes së përgjithshme të informatave dhe kontingjenteve që do të veçohen për asgjësim me tendencë arratisje dhe agitacion e propagandë, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”. Dokumenti i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Berat.

16. **Dosje përpunimi nr. 304**, në ngarkim të **Dh.G.**, me 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

17. **Dosje përpunimi nr. 801**, në ngarkim të **V.K.**, me 201 (dyqind e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

18. **Dosje formulare nr. 3672**, në ngarkim të **M.P.**, me 91 (nëntëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.



19. **Dosje formulare nr. 15**, në ngarkim të **M.D.**, me 525 (pesëqind e njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

20. **Dosje e demonstratave mars 1982**, me 2 volume, me 593 (pesëqind e nëntëdhjetë e tre) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria II.

21. **Dosje me Analiza e diskutime – Rezidenca Beograd** (vitet 1972, 1973, 1975, 1976, 1977, 1978, 1979, 1980, 1981), me 149 (njëqind e dyzet e nëntë) fletë. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria II.

22. **Fashikull mbi ngjarjet e Kosovës prill-maj 1981**, me 211 (dyqind e njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të fashikullit është “Tepër sekret”. Fashikulli i përket Fondit ish-Dega XIII.

23. **Fashikull mbi grumbullimin e materialeve për ndjekjen e ngjarjeve në Kosovë, nr. 548**, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të fashikullit është “Tepër sekret”. Fashikulli i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Korçë.

24. **Fashikull për ngjarjet e ndodhura në Kosovë në muajin prill 1981**, me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të fashikullit është “Tepër sekret”. Fashikulli i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

25. **Dosje e çështjes së veçantë, nr. 60, qëllimi i goditjeve në Kosovë, vitet 1975–1980**, me 375 (treqind e shtatëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria II.

26. **Dosje e çështjes së veçantë, nr. 60, qëllimi i goditjeve në Kosovë e vise, vitet 1983–1988**, me 379 (treqind e shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria II.

27. **Dosje e çështjes së veçantë, nr. 60, qëllimi i goditjeve në Kosovë e vise, vitet 1988–1989**, me 287 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria II.

28. **Dosje e çështjes së veçantë, nr. 60, qëllimi i goditjeve në Kosovë e vise, vitet 1989–1990**, me 213 (dyqind e trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria II.

29. **Fondi nr. 4, Drejtoria I, viti 1982, Dosja nr. 117** “Deklarata e P. R. në ngarkim të N. B. dhe

30 copë negativa filmi”, me 41 (dyzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

30. **Fondi nr. 4, Drejtoria I, viti 1990, Dosja nr. 434** “Mbi disa dëmtime dhe probleme në Minierën e Qymyrgurit në Valias”, me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

31. **Fondi nr. 4, Drejtoria I, viti 1990, Dosja nr. 654** “Informacion për disa të dhëna të mprehta, komente me karakter armiqësor dhe për organizim demonstratash”, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

32. **Fondi nr. 4, Drejtoria I, viti 1990, Dosja nr. 648** “Për disa përpjekje për organizimin e një mitingu nga studentët e Institutit të Lartë Pedagogjik Gjirokastrë”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

33. **Fondi nr. 4, Drejtoria I, viti 1990, Dosja nr. 649** “Për disa fletushka që bëjnë thirrje për demonstratë dhe nxitje të mëtejshme të trazirave në Durrës etj.”, me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

34. **Fondi nr. 4, Drejtoria I, viti 1983, Dosja nr. 121** “Informacion i zv.ministrit të punëve të jashtme për vendimin e SHBA-së ndaj çështjes së Kosovës, 18.10.1983”, me 2 (dy) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1983. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

35. **Fondi nr. 4, Drejtoria I, viti 1981, Dosja nr. 72** “Informacion dërguar udhëheqjes Partisë e Shtetit mbi gjendjen në Kosovë, komentet për situatën atje dhe personat e ardhur nga krahinat shqiptare në Jugosllavi pas demonstratave të Kosovës”, me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

36. **Fondi nr. 4, Drejtoria I, viti 1981, Dosja nr. 71** “Informacion dërguar udhëheqjes Partisë e Shtetit mbi komentet e diplomatëve të vendeve kapitaliste-revizioniste mbi gjendjen në vendin tonë dhe ngjarjet në Kosovë”, me 41 (dyzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

37. **Fashikull nr. 12191**, në ngarkim të **B.P.**, me 171 (njëqind e shtatëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të fashikullit është “Tepër sekret”. Ky fashikull i përket Fondit Kosova.

38. **Dosje O.R.V. nr. 126, T.O.B.**, me 2 fashikuj përkatësisht 8 (tetë) dhe 130 (njëqind e tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

39. **Dosje O.R.V. Radio Televizioni Shqiptar**, me 2 fashikuj përkatësisht 20 (njëzet) dhe 340



(treqind e dyzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

40. **Dosje O.R.V.** nr. 133, Kinostudio “Shqipëria e Re”, me 2 volume përkatësisht 11(njëmbëdhjetë) dhe 150 (njëqind e pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të fashikullit është “Sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

41. **Dosje formulare nr. 42980**, në ngarkim të **L.L.** me tri volume me 555 (pesëqind e pesëdhjetë e pesë) fletë në total. Dosja i përket Fondit ish-Dega XIII.

KRYETAR I KOMISIONIT TË
DEKLASIFIKIMIT
DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula

VENDIM
Nr. 68, datë 12.3.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“DRAGOBIA ENERGY” SHPK, PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 10, pikat 1, 2 dhe 3, dhe të nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 35/1 prot., datë 4.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. për rinovim licence në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 403 prot.,

datë 1.3.2021, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, përcaktohet si vijon:

Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës.

- Referuar sa më sipër, vlefshmëria e licencës nr. 333, seria F16, dhënë shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., me vendimin e ERE-s nr. 19, datë 16.2.2016, rezulton se ka përfunduar në datën 16.2.2021, ndaj afati i fundit për aplikim nga shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. për rinovimin e kësaj licence duhet të ishte data 16.12.2020. Nga sa konstatuar, shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. nuk ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës, pasi aplikimi i saj është paraqitur në ERE në datën 1.3.2021.

- Në nenin 10, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, përcaktohet si vijon:

Çdo aplikim do të paraqitet në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje, duke plotësuar kërkesat dhe dokumentet e kërkuara në të. Në të kundërt Bordit të ERE-s i propozohet mosfillimi i procedurave të shqyrtimit të aplikimit.

- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. nuk ka përcjellë bashkëlidhur kërkesës së saj asnjë dokumentacion dhe nuk ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, nr. 333, seria F16, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 19, datë 16.2.2016.



2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 69, datë 12.3.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KROI MBRET ENERGJI” SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 461/1, SERIA P20, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 41, DATË 6.3.2020, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “BACKA 1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1600 kw, HEC “BACKA 2” ME KAPACITET TË INSTALUAR 4000 kw, HEC “BACKA A” ME KAPACITET TË INSTALUAR 500 kw, HEC “BACKA B”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 500 kw, HEC “BACKA C” ME KAPACITET TË INSTALUAR 720 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 7320 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë Elektrike”, të ndryshuar; të nenit 10, pika 3 dhe të nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 19, pika 1, germa “a” dhe 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 35/6 prot., datë 11.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi fillimin e procedurës për

modifikimin e licencës së shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 41, datë 6.3.2020, Bordi i ERE-s vendosi të licencojë shoqërinë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Backa 1”; me kapacitet të instaluar 1600 kw; “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kw, “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kw; “Backa B” me kapacitet të instaluar 500 kw dhe “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet total 7320 kw, për një afat 28 vjet e 5 muaj, me kusht që përpara fillimit të operimit të veprimtarisë, shoqëria të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor. Këto HEC-e ndodhen në lumin e Straveckës, rrethi i Skraparit.

- Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., me shkresën nr. 51 prot., datë 5.3.2021, ka përcjellë në ERE kërkesën për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.

- Kërkesa për modifikimin e licencës nr. 461/1, seria P20, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 6.3.2020, sipërcituar, vjen për arsye se kanë ndodhur ndryshime në karakteristikat e HEC-eve, ku nga 5 (pesë) HEC-e do të jenë 3 (tri) HEC-e, konkretisht HEC Backa “1”, “A”, “C”.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 3059/4 prot., datë 18.6.2020, drejtuar shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k, për dijeni Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), ka miratuar projektin e zbatimit përfundimtar (të ndryshuar) të HEC “Backa 1”, “A”, “C”.

- Në vijim të sa më sipër, shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. dhe MIE kanë lidhur kontratën shtesë të koncesionit me nr. 3889 rep., nr. 959 kol., datë 27.7.2020, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim - operim - transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B” dhe “Backa C”.

- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton i plotësuar pjesërisht, si më poshtë:

Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, në rastin e modifikimit/ndryshimit të licencës me



kërkesë të të licencuarit, ERE zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin, duke kërkuar informacionin e mëposhtëm:

- germa “a”, një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës). Plotësuar;

- germa “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. Plotësuar;

- germa “e”, të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE. Plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Formatin dhe dokumentacionin për aplikim:

- Neni 9, pika 1, germa “a” (të dhënat për aplikim), germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) dhe germa “c” (të dhëna për aplikuesin);

- Neni 15, pika 4:

- germa “b”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës;

- germa “d”, ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi, do të njoftohet subjekti që t'i paraqesë ato brenda afateve që përcakton “Rregulloja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Gjithashtu në kuptim të nenit 11, pika 1, të “Rregullores së licencimit shoqërisë ‘Kroi Mbret Energji’ sh.p.k.”, do t'i kërkohej në vijim edhe informacion rreth vlefshmërisë së “Marrëveshjes për lidhje të re” që ka nënshkruar me OSHEE sh.a., në kuadër të ndryshimeve të karakteristikave të HEC, të cilat prekin kapacitetin total të instaluar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., nr. 461/1, seria P20, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 6.3.2020, për prodhimin e energjisë elektrike, për një afat 28 vjet e 5 muaj, me kusht që përpara fillimit të operimit të veprimtarisë, shoqëria të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor, në përputhje me parashikimet e kontratës shtesë të koncesionit nr. 3889 rep., nr. 959 kol., datë 27.7.2020, “Për disa

ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim - operim - transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve ‘Backa 1’, ‘Backa 2’, ‘Backa A’, ‘Backa B’ dhe ‘Backa C’”, si më poshtë:

Ishte: HEC “Backa 1” me kapacitet të instaluar 1600 kw;

HEC “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kw;

HEC “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kw;

HEC “Backa B” me kapacitet të instaluar 500 kw;

HEC “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kw;

me kapacitet total 7320 kw.

Bëhet: HEC “Backa 1” me kapacitet të instaluar 3366 kw;

HEC “Backa A” me kapacitet të instaluar 1347 kw;

HEC “Backa C” me kapacitet të instaluar 1910 kw;

me kapacitet total 6623 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 70, datë 12.3.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“KURUM INTERNATIONAL” SHA, PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 213,
SERIA PM13P, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 132, DATË 6.12.2011, TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-
s DHE TRANSFERUAR ME VENDIMIN
NR. 126, DATË 28.10.2013, TË BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-s, TE
SHOQËRIA “KURUM
INTERNATIONAL” SHA, PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “ULËZ”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 24 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 10, pika 3 dhe nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 19, pika 1, germa “a” dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 35/5 prot., datë 11.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a.,

konstatoi se:

-Shoqëria “Kurum International” sh.a., me shkresën nr. 427 prot., datë 5.3.2021, ka përcjellë në ERE kërkesën për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike për HEC “Ulëz”.

-Kërkesa për modifikim, vjen për arsye se gjatë rehabilitimit të këtij HEC-i, në lidhje me optimizimin e operimit të turbinave, janë zëvendësuar me pajisje te reja disa pajisje kryesore të HEC-it, çka ka sjellë edhe rritjen e kapacitetit të tij me 6 mw.

-Licencat e dhëna nga ERE me vendimin nr. 132/2011, “Për licencimin e shoqërisë ‘HEC Ulëz – Shkopet’ sh.a. në aktivitetin e prodhimit të

energjisë elektrike nga HEC “Ulëz” dhe “Shkopet”, dhe me vendimin nr. 136/2011, “Për licencimin e shoqërisë ‘HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2’ sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC ‘Bistrica 1 dhe Bistrica 2’”, janë transferuar te shoqëria “Kurum International” sh.a. me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 126, datë 28.10.2013, me nr. 213, seria PM13P.

-Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “Kurum International” sh.a., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton i plotësuar si më poshtë:

Në zbatim të nenit 7, “Delegimi i të drejtave të aplikuesit”, pika 2, germa “a”, do t’i kërkohej shoqërisë “Kurum International” sh.a., të depozitojë në ERE autorizimin për përfaqësuesin ligjor të saj.

Formati dhe dokumentacioni për aplikim:

- Neni 9, pika 1, germa “a” (të dhënat për aplikim), germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) dhe germa “c” (të dhëna për aplikuesin). Plotësuar;

- Neni 15, pika 4:

- germa “a”, një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës. Plotësuar;

- germa “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. Nuk aplikohet për këtë rast, pasi HEC “Ulëz” është HEC privat;

- germa “e”, të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE. Plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me nenin 15, pika 4:

- germa “b”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës. Pa plotësuar;

- germa “d”, ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi. Pa plotësuar, do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë ato brenda afateve që përcakton “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Po ashtu, në kuptim të nenit 11, pika 1, të “Rregullores së licencimit, shoqërisë ‘Kurum



International' sh.a'”, do t'i kërkohej edhe informacion rreth vlefshmërisë së “Marrëveshjes për lidhje të re”, që ka nënshkruar me OST sh.a., në kuadër të ndryshimeve të karakteristikave të HEC, të cilat prekin kapacitetin total të instaluar dhe vlefshmërinë e lejes mjedisore që disponon.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës me nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të shoqëria “Kurum Interntional” sh.a., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Ulëz” me kapacitet të instaluar 24 mw, si më poshtë:

Ishte: kapaciteti i instaluar 24 MW.

Bëhet: kapaciteti i instaluar 31 MW.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 71, datë 12.3.2021

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN SHKURT 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë Së Fundit”, miratuar

me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 35/2 prot., datë 9.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, për muajin shkurt 2021,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.) me shkresën nr. 2218 prot., datë 4.3.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për muajin shkurt 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021”, është 0.75 lekë/kwh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV: bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të Bordit të ERE-s “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit, për vitin 2021”, është 1.5 lekë/kwh.

- Sasi e energjisë elektrike e prokuruar në treg të parregulluar dhe nga burimet e rinovueshme është 1,790 mwh.

Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin shkurt 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:



Çmimi i FMF-së për muajin Shkurt 2021

Shkurt 2021		Aplikimi FSHU sh.a.	Përlogaritjet e ERE
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	6.553
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	<u>Leke/kWh</u>	<u>0.20</u>
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	6.75
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRrTSHt + CA		Leke/kWh	10.79

- Për sa përcaktuar, për çdo element të formulës përlogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionet të procedurës së blerjes së energjisë nga FTL sh.a., si dhe vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2021, të jetë 10.79 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 10.79 lekë/kwh, për muajin shkurt 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendrike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 72, datë 12.3.2021

**MBI MIRATIMIN E “RREGULLAVE
OPERACIONALE PËR FURNIZUESIN E
NGARKUAR ME DETYRIMIN E
SHËRBIMIT PUBLIK, PËR SEKTORIN E
GAZIT NATYROR”**

- Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 16 dhe 92, pika 3, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të

vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 533, datë 25.7.2019, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”; të neneve 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 35/3 prot., datë 9.3.2021, për miratimin e draftit mbi “Rregullat operationale për furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror”, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror,

konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 92, pika 3, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, ERE miraton “Rregullat operationale për furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 267, datë 28.12.2020, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e “Kushteve për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u bënë publikimet në faqen e *web-it* të ERE-s, njoftimi në median e shkruar me shkresën e ERE-s nr. 6/2 prot., datë 8.1.2021, si dhe njoftimi për botimin në Fletoren Zyrtare nr. 8, datë 18.1.2021.

- Me shkresën nr. 34 prot., datë 11.1.2021, ERE kërkoi marrje mendimi nga palët e interesit si vijon: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit Shqiptar, Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit, Shoqata e Konsumatorit në Fokus,



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Albpetrol” sh.a., “Albgaz” sh.a., “Tap AG Albania” sh.p.k., “Balkgaz” sh.p.k., “Phoenix Petroleum” sh.a., “CGC” sh.p.k., “GSA” sh.p.k., dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, për opinione dhe komente në lidhje me këtë drafttregullore, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni.

- Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve dhe objeksioneve nga palët, rezultoi se nëpërmjet shkresës nr. 80/1 prot., datë 29.1.2021, protokolluar në ERE me shkresën nr. 34/2 prot., datë 2.2.2021, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është shprehur se në tërësi rregullorja vlerësohet e hartuar konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Me shkresën nr. 7/1 prot., datë 25.1.202, protokolluar në ERE me shkresën nr. 34/1 prot., datë 25.1.2021, Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror, Albgaaz sh.a., dha disa sugjerime për nenet (1,4,5,9 dhe 11) të drafttregullores, që lidhen me saktësimin e përkufizimit të kushteve për furnizuesit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik dhe jo për të gjithë operatorët që ofrojnë shërbimin publik, në zbatim të nenit 92, pika 3, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar. Sugjerimet e ardhura nga Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror, Albgaaz sh.a., janë reflektuar në draftin final të rregullave operacionale për furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror.

Nuk rezulton të ketë asnjë koment, vërejtje apo sugjerim nga palët e tjera të interesit në lidhje me përmbajtjen e draftit të rregullave operacionale për furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit, me të cilin Bordi i ERE-s ka filluar procedurën.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullave operacionale për furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

RREGULLAT OPERACIONALE PËR FURNIZUESIN E NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK, PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe objekti

1. Rregullat operacionale për furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, për sektorin e gazit natyror, kanë për qëllim të përcaktojnë dhe të sigurojnë shërbimin publik të furnizimit me gaz natyror nga furnizuesi i ngarkuar me këtë detyrim (këtu e më poshtë- Furnizuesi i Shërbimit Publik - FSHP), në mbështetje të parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

2. Shërbimi publik i furnizimit është një detyrim i shërbimit publik që i vendoset Furnizuesit të Shërbimit Publik (FSHP), i cili siguron të drejtën e furnizimit me gaz natyror për klientët që përfitojnë nga shërbimi publik në Republikën e Shqipërisë, me një cilësi të caktuar të furnizimit, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente e jodiskriminuese, me qëllim mbrojtjen e tyre nga rritjet e paarsyetuara të çmimit duke synuar në arritjen e një tregu konkurrues, të sigurt e të qëndrueshëm të gazit natyror nga pikëpamja mjedisore, pa qenë të diskriminuar në të drejtat dhe detyrimet e tyre, siç parashikuar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

Neni 2 Baza ligjore

1. Këto rregulla/kushte hartohen në mbështetje të nenit 23, germa “P” dhe nenit 92, pika 3, të ligjit



nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 533, datë 25.7.2019, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”.

Neni 3

Termet dhe përkufizimet

1. Kjo rregullore ka ndërvaresi, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në tërësi, si dhe në veçanti me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, Kodet e Rrjetit dhe metodologjitë e miratuara nga ERE, për sektorin e gazit natyror.

2. Në këto rregulla, termet e mëposhtme do të kenë këto kuptime:

“**Enti Rregullator i Energjisë**” ose “**ERE**” është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për sektorin e energjisë elektrike “ERE” në Shqipëri;

“**Shërbim publik**” është shërbimi që sigurohet nga një i licencuar që operon në sektorin e gazit natyror, që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, çmimet e rregulluara në sektorin e gazit natyror, eficiencën e gazit natyror, energjinë nga burimet e rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, përmbushja e të cilit nuk cenon konkurrencën, përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë;

“**Detyrim i shërbimit publik**” është detyrimi që vendoset ndaj një të licencuari për kryerjen e një shërbimi publik, që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, çmimet e rregulluara në sektorin e gazit natyror, eficiencën e energjisë, mbrojtjen e mjedisit, përmbushja e të cilit nuk cenon konkurrencën, përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë;

“**Furnizim**” është shitja dhe rishitja e gazit natyror, përfshirë GNL-në, te klientët.

“**Furnizuesi**” subjekti që furnizon (shet dhe i rishet gazin) klientin në bazë të një kontratë furnizimi;

“**Person**” është çdo person fizik ose juridik, qeveria ose çdo agjenci shtetërore, çdo autoritet lokal ose ente të tjera juridike të njohura nga ligji brenda dhe jashtë vendit, përveç ERE-s;

“**Siguri**” është siguria e furnizimit me gaz natyror dhe siguria teknike;

“**Rrjet**” është një sistem i ndërlidhur tubacionesh;

“**Klient fundor**” është klienti që e blen gazin natyror për përdorim vetjak;

“**Klient në nevojë**” është një klient familjar, i cili, për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta, lidhur me furnizimin me gaz, të siguruar në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

“**Klient familjar**” është klienti që blen gaz për konsum familjar dhe jo për veprimtari tregtare ose profesionale;

“**Klient jofamiljar**” janë personat fizikë ose juridikë që blejnë gaz natyror, i cili nuk shkon për përdorim familjar, prodhuesit dhe klientët e shumicës;

“**Operator i rrjetit**” është Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe/ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes;

“**Kontratë furnizimi me gaz**” është një kontratë për furnizim me gaz natyror, por që nuk përfshin derivativët e gazit natyror;

“**Metodologji e tarifave**” është akti që përcakton kushtet dhe mënyrën e llogaritjes së tarifave të veprimtarive të rregulluara të gazit natyror;

“**Rregulla të praktikës dhe të procedurave**” janë rregullat e miratuara nga Bordi i ERE-s, ku përcaktohen procedurat dhe afatet që zbaton ERE;

II. DISPOZITA TË VEÇANTA PËR DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK

Neni 4

Furnizuesi i shërbimit publik

1. Shoqëria e licencuar dhe e caktuar në rolin e furnizuesit të gazit natyror, i vendoset detyrimi i shërbimit publik, sipas përcaktimeve të nenit 89, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.



2. Duke qenë i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, Furnizuesi i Shërbimit Publik është i detyruar të kryej furnizimin e klientëve, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 533, datë 25.7.2019, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”.

3. Furnizuesi, i cili ka detyrimin e shërbimit publik, duhet:

a) të sigurojë furnizim si një shërbim publik për të gjithë ata klientë të parashikuar në këtë rregullore dhe që gëzojnë të drejtën nga ky lloj furnizimi;

b) të kryejë furnizimin në kuadër të shërbimit publik, ekskluzivisht, sipas tarifave të përcaktuara nga ERE, të cilat bazohen në kushte të rregulluara;

c) të ndërmarrë masa që të realizojë një furnizim të sigurt, të besueshëm dhe cilësor të këtyre klientëve, sipas kuadrit të shërbimit publik.

Neni 5

Detyrimi i shërbimit publik të furnizimit

1. Për të siguruar këtë shërbim, si masa mbrojtëse për interesat e përgjithshme, ndaj Furnizuesit të Shërbimit Publik, vendosen detyrimet e mëposhtme:

a) furnizim me çmim të rregulluar të gazit natyror si caktuar në kontratë;

b) sasia e gazit natyror përcaktohet në kontratën e rregulluar ndërmjet palëve, që miratohet nga ERE;

c) Furnizuesi i Shërbimit Publik duhet t’u ofrojë klientëve të drejtën e kontratave standarde, të përgatitura në bazë të kushteve standarde të furnizimit me gaz natyror, të miratuara nga ERE, në përputhje me nenin 95, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe legjislacionit përkatës për mbrojtjen e klientëve.

Neni 6

Furnizimi i gazit natyror me çmim të rregulluar

1. Çmimi i gazit natyror për sasi të ofruara do të jetë i rregulluar në përputhje me përcaktimet si në pikën 5, të VKM-së nr. 533, datë 25.7.2019, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të

zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”.

2. Detyrimi i shërbimit publik të furnizimit vendoset në mënyrë që klientët të furnizohen me gaz natyror nga Furnizuesi i Shërbimit Publik, me çmime të rregulluara, që miratohen nga ERE, në përputhje me nenin 92, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar dhe metodologjitë e miratuara nga ERE.

Neni 7

Rregullimi i furnizimit me gaz natyror

1. Furnizuesi i shërbimit publik duhet t’u ofrojë klientëve, të cilët kanë të drejtën e shërbimit publik, shërbimin e furnizimit konform kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s.

2. Furnizuesi, i cili ka detyrimin e ofrimit të shërbimit publik, duhet t’i dorëzojë klientit fundor kontratën e lidhur me shkrim, brenda 8 ditëve nga dita në të cilën ka filluar furnizimi.

3. Furnizuesi i shërbimit publik duhet të mbajë një regjistër për numrin e klientëve të furnizuar prej tij dhe një regjistër të posaçëm me çdo të dhënë të këtyre klientëve i cili duhet të përditësohet rregullisht dhe duhet t’i komunikohet operatorit të rrjetit dhe ERE-s.

4. Furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik mund të ndërpresë furnizimin e klientëve, si përcaktuar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe në rregulloret e miratuara nga ERE.

Neni 8

Klientët në nevojë

1. Furnizimi i klientëve në nevojë kryhet nga furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik si caktohet në nenin 97, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

2. Klientët familjarë, që kane fituar statusin e klientëve në nevojë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 97, të ligjit nr. 102/2015, kanë



të drejtën e përfitimit të shërbimit publik të furnizimit.

3. Furnizuesi, i cili është i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, lidh brenda 5 ditëve nga dita e regjistrimit të klientit në nevojë, kontratën për furnizimin me gaz natyror.

4. Të gjitha shpenzimet e bëra nga furnizuesi në lidhje me kushtet e veçanta të furnizimit për këtë kategori klientësh, gjatë një viti, të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, mbulohen nga tarifat e atij viti. Në vitin pasardhës mund të bëhet rregullimi i të ardhurave në varësi të performancës së vitit të mëparshëm.

5. Furnizuesi, që furnizon me gaz natyror klientin në nevojë, mund të ndërpresë shërbimin, bazuar në kushtet specifike për këtë kategori klientësh, të miratuara nga ERE.

Neni 9

Cilësia e shërbimit

1. Standardet e cilësisë së furnizimit, duke përfshirë kërkesat e nevojshme të vazhdimësisë së furnizimit në një nivel të qëndrueshëm të presionit nga Furnizuesi i Shërbimit Publik, të përfshira në rregulloret dhe kodet ekzistuese, do të konsiderohen detyrime të shërbimit publik.

2. Standardet e Performancës së Cilësisë ose “QPP” janë parametra të paracaktuar të përdorura për të matur nivelin e performancës së shërbimeve dhe furnizimit të gazit natyror, siç përcaktohet në “Rregulloren për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimeve dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s.

Neni 10

Monitorimi dhe mbikëqyrja

1. ERE, duke vepruar brenda kompetencave të saj, kryen monitorimin dhe mbikëqyrjen për zbatimin e termave e kushteve të licencës përkatëse për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për tregun e gazit natyror në Shqipëri.

2. Furnizuesit e shërbimit publik që shkelin kushtet e përcaktuara si më sipër, do të jenë përgjegjës sipas dispozitave të nenit 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

3. Furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik do t'i dërgojë ERE-s një informacion dhe deklaratë me shkrim për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit të realizuar si detyrim i shërbimit publik gjatë vitit paraardhës, sipas kërkesave të raportimit të vendosura nga ERE sipas nenit 16, pika 24, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet Furnizuesit të shërbimit publik dhe klientëve, do të trajtohet nga ERE, në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror”.

Neni 12

Rishikimi dhe amendimi

Kjo rregullore mund të rishikohet dhe/ose të amendohet vetëm nëpërmjet një vendimi të Bordit të ERE-s.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 79, datë 23.3.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBGAS” SHA, PËR SHTYRJE TË AFATIT TË VENDIMARRJES FINALE TË BORDIT TË ERE-s

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 16, pika 12, dhe neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin,



funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 38/3 prot., datë 18.3.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

- Pas kërkesave të përsëritura të aplikuesit për zgjatjen e afatit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencim, ERE, me vendimet nr. 43, datë 6.3.2020, nr. 119, datë 17.7.2020, dhe së fundmi, me vendimin nr. 179, datë 4.11.2020, vendosi për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Albgaz” sh.a., për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 20.3.2021.

- Ndërkohë përpara përfundimit të afatit të sipërcituar, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka paraqitur shkresën e protokolluar në ERE me nr. 454 prot., datë 18.3.2021, duke kërkuar sërish shtyrjen e këtij afati procedural deri në datën 20.9.2021, për shkak se shumë projekte fizibiliteti u pezulluan për një kohë më të gjatë se sa ajo e parashikuar për arsye të pandemisë COVID-19 dhe, si e tillë, shoqëria

“Albgaz” sh.a., nuk disponon ende të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ERE.

- Kërkesa e “Albgaz” sh.a. rezultoi e depozituar brenda afatit të përcaktuar në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili përcakton se:

3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 20.9.2021.

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a. të marrë masa për të depozituar në ERE dokumentacionin e munguar, jo më vonë se data 10.9.2021.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palën e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë